

VENDIM
Nr. 187, datë 10.11.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ALBGAS SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të neneve 4, pika 50 dhe nenit 22, pika 2, germa “b”; 24, pika 2 dhe nenit 50, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “b”; neneve 5, 11 dhe 12 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

- Shoqëria Albgaz sh.a., me shkresën nr. 62 prot, datë 19.7.2017, ka paraqitur pranë ERE-s aplikimin për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 16.8.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 179, datë 8.11.2017, miratoi certifikimin e shoqërisë Albgaz sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror.

- Me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017, bordi i ERE-s ka lënë në fuqi vendimin e bordit të ERE-s nr. 90, datë 7.6.2017, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017”, deri më 31.12.2017.

- Me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, bordi i ERE-s miratoi edhe “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

- Albgaz sh.a., me shkresat nr. 521/4 prot. të ERE-s, datë 9.10.2017, nr. 139 prot. të ERE-s, datë 21.11.2017 dhe nr. 139/1 prot., datë 7.11.2017, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacioni për aplikimin e tij.

- Aplikimi i shoqërisë Albgaz sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” (pikat “i”, “ii”, “iv”); germa “e”, “Dokumentacioni dhe garancitë financiare”, pikat “i”, “ii”, “v”, “vi”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9, pika 2, germa “b”, pikat “i”, “ii”, “iii”, “v”, “vi”, “vii”, “viii”, “ix”, “x”, “xi”, “xii”, “xiii”, “xiv”, “xv”.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa “d” (pikat “v”, “vi”).

- Dokumentacionin dhe garancitë financiare, neni 9, pika 1, germa “e”, pikat “iv”, “vi”.

- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9, pika 2, germa “b”, pikat “iv”, “xv”, “xvii”, “xviii”, do të njoftohet subjekti që t’i depozitojë ato brenda afatit të përcaktuar në kushtin e dispozitivit të vendimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose për të plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.

- Lejet dhe autorizimet mjedisore.
- Një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuar, ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD.

- Plan biznesi.
- Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit.
- Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
- Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes.
- Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

2. Shoqëria e licencuar ka detyrimin të respektojë kushtet e parashikuara në licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror që miraton bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti